



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:169143
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05740918

K.DH.Shk II.nr.548/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Lux” SH.P.K., me NUI:810712093, me seli Lipjan, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit N.T. avokat nga Lipjani Rr.” Lidhja e Prizrenit”, kundër debitorit “Doni Product” SH.P.K., me NUI: 810197310, me seli në Ferizaj Rr.”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” sh.p.k., me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1389/22 të datës 12.12.2023, me datë **28.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Doni Product” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1389/22 të datës 12.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1389/22 të datës 12.12.2023, në pikën I të dispozitivit e ka lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit nga debitori “Doni Product” SH.P.K., ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.843/21 të datës 30.06.2021, të Përmbarruesit Privat Driton Govori. Në pikën II të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Doni Product” SH.P.K., ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri Përmbarrimor P.nr.843/21 të datës 30.06.2021 të Përmbarruesit Privat Driton Govori, për pjesën e detyrimit në shumën prej 7,450.17 €. Në pikën III të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit “Doni Product” SH.P.K., ashtu që ka lënë në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarrimor P.nr.843/21 të datës 30.06.2021, të Përmbarruesit Privat Driton Govori, sa i përket shumës prej 6,139.30 €. Ndërsa në pikën IV të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përmbarrimore e kreditorit “Lux” SH.P.K., ndaj debitorit “Doni Product” SH.P.K., sipas urdhrit P.nr.843/21 të datës 30.06.2021, për pjesën e detyrimit në shumën prej 7,450.17 €. Ndërsa në pikën V të dispozitivit në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 7,450.17 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1389/22 të datës 12.12.2023.

Tutje, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 01.03.2024, ka nxjerrë aktvendimin korrigjues ashtu që aktvendimin me nr.KPPP.nr.1389/22 të datës 12.12.2023 në të cilin ka ndodhur një gabim teknik ku në faqen e parë në pikën V të dispozitivit është shënuar “në shumë prej 7,450.17€” e që duhet të jetë në shumë prej 6,139.30€.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar kreditori nëpërmjet të cilës ka propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta lë në fuqi propozimin për përmbarrim dhe urdhri përmbarrimor i kreditorit Lux, sh.p.k ndaj debitorit “Doni Product Sh.p.k, për pagimin e borxhit në afat prej 7 ditësh.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Lux” SH.P.K., ka paraqitur propozim për përmbaremore në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht fatura me numër 625/20 e datës 24.08.2020, fatura me numër 665/20 e datës 02.10.2020, fatura me numër 668/20 e datës 09.10.2020, fatura me numër 637/20 e datës 10.09.2020, fatura me numër 629/20 e datës 02.09.2020, fatura me numër 626/20 e datës 26.08.2020 dhe fatura me numër 647/20 e datës 21.09.2020, duke urdhëruar debitorin t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 13,589.47 €, si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit në shume prej 312.00 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Debitori me datë 22.07.2021, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit, ndër të tjerash ka theksuar se me datë 21.07.2021, është njoftuar nga banka për bllokimin e llogarisë sipas urdhërit të lëshuar sipas propozimit të kreditorit. Ka shtuar se ka kontaktuar zyrtarët e Postës së Kosovës në Ferizaj dhe ka vërtetuar faktin se pranimi i urdhërit është bërë nga një person i pa autorizuar dhe atë gruaja e një kushëriri të pronarit të kompanisë, fakt i vërtetuar sipas nënshkrimit në dëshminë e postës, pra dorëzimi nuk është bërë në selinë e depos së debitorit por në një shtëpi banimi afër depos, andaj debitori pa fajin e tij ka humbur afatin për paraqitjen e prapësimit.

Kreditori ka ushtruar përgjigje ndaj kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme duke theksuar se kërkesa për kthimin në gjendje të mëparshme është e pa qëndrueshme pasi që në bazë të shkresave të lëndës dhe fletë kthesave nga ana e postës shihet qartë që propozimi për përmbaremore dhe urdhri përmbaremore është dorëzuar në mënyrë të rregullt, i ka propozuar gjykatës që kërkesa e debitorit të refuzohet.

Debitori me datë 22.07.2021, ka paraqitur edhe mjetin juridik të prapësimit, në të cilin ka theksuar se e kundërshton në tërësi urdhërin përmbaremore, ndër të tjerash ka theksuar se në bazë të dokumentit në bazë të cilit është marr vendimi përmbaremore ose urdhri përmbaremore është

prishur, anuluar, ndryshuar apo shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik. Më tutje ka shtuar se edhe sikur të ekzistonte borxhi i pretenduar, nëse shikohet fatura dhe mblidhet borxhi i këtyre faturave del shuma totale e tyre prej 6,136.00 euro, pra totali i të gjitha faturave që po kërkohet të përmbahet, ndërsa kreditori po e kërkon një borxh prej 13,589.47 euro, i cili borxh pra nuk buron nga fatura që po kërkohet të ekzekutohet. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbahimor, si dhe të detyrohet kreditori t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimin në shumë prej 104.00 euro.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit duke theksuar se në prapësimin e ushtruar të palës debitorë nuk është arritur që me fakte dhe prova bindëse që urdhri përmbahimor është i pa lejuar. Më tutje ka shtuar se propozimi dhe urdhri për përmbahim i datës 30.06.2021, ka të bëjë vetëm për faturat e specifikuar të cilat fatura janë të pa paguara dhe njëkohësisht janë objekt i kësaj çështje përmbahimore dhe është në harmoni me LPP-në, ndërsa prapësimi nuk i përmbush shkaqet e parapara në nenin 71.1 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të mbetet në fuqi urdhri përmbahimor, e prapësimi i debitorit të cilësohet jashtë afatit ligjor si dhe të detyrohet debitori t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1389/22 të datës 12.12.2023 në pikën I të dispozitivit e ka lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimin nga debitori "Doni Product" SH.P.K., ndaj Urdhrit Përmbahimor P.nr.843/21 të datës 30.06.2021, të Përmbahuesit Privat Driton Govori. Në pikën II të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit "Doni Product" SH.P.K., ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri Përmbahimor P.nr.843/21 të datës 30.06.2021 të Përmbahuesit Privat Driton Govori, për pjesën e detyrimit në shumën prej 7,450.17 €. Në pikën III të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimi i debitorit "Doni Product" SH.P.K., ashtu që ka lënë në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbahimor P.nr.843/21 të datës 30.06.2021, të Përmbahuesit Privat Driton Govori, sa i përket shumës prej 6,139.30 €. Ndërsa në pikën IV të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përmbahimore e kreditorit "Lux" SH.P.K., ndaj debitorit "Doni Product" SH.P.K., sipas urdhrit P.nr.843/21 të datës 30.06.2021, për pjesën e detyrimit në shumën prej 7,450.17 €. Ndërsa në pikën V të

dispozitivit në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 7,450.17 euro.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata lidhur me kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke u bazuar në dispozitën e nenit 68 par. 2 të LPP-së, pasi që debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt propozimin për përmbarim dhe urdhrin përmbarimor konform dispozitave ligjore në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimeve të shkresave gjeti se vlera në propozimin për përmbarim është 13,589.47 € ndërsa në faturat e lartcekura del të jetë 6,139.30 €, pra ekziston një mospërputhje në vlerë prej 7,450.17 €, për këtë arsye gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi. Gjykata vendosi sikur në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbaruesit privat P.nr.843/2021 të datës 30.06.2021, për pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej 6,139.30 € për faktin se dokumenti i besueshëm – faturat e lartcekura i plotësojnë në tërësi kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, si dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret nuk përputhen vlerat e urdhrin përmbarimor dhe faturave të bashkangjitura në propozim për përmbarim gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit ndërsa urdhrin përmbarimor e lë në fuqi, sa i përket pjesës së mbetur prej 6,139.30 €.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka lejuar kthimin në gjendje të mëparshme të prapësimit të debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se nga fletë kthesa e dorëzuar në Postë me datën 06.07.2021, nuk mund të vërtetohet se debitori e ka pranuar personalisht propozimin për përmbarim dhe urdhrin përmbarimor, kjo për faktin se rubrika ku duhet të nënshkruhet nga marrësi nuk është e nënshkruar por është e nënshkruar vetëm rubrika e cila parashihet “Vërejtje e dërguesit në rast të mosdorëzimit”, ashtu siç me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë.

Ndërsa, përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Mirëpo meqenëse vlera në propozimin për përmbarim është 13,589.47 € ndërsa në faturat e lartcekura del të jetë 6,139.30 €, pra ekziston një mospërputhje në vlerë prej 7,450.17 €, për këtë arsye gjykata vendosi sikur në piken II të dispozitivit të këtij aktvendimi që të anuloi pjesërisht propozimin për përmbarim për pjesën e detyrimit në shumën prej 7,450.17 €, ndërsa ta lë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin përmbarimor sa i përket shumës prej 6,139.30 €.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të debitorit por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për, vendosjen ndryshe andaj, vendosi që aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj. Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk II.nr. 548/24 , Datë:28.05.2024

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti**